



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Tubimi në Tiranë/ Protesta ndahet në dy grupe, thellohet përçarja mes të pranishmëve! Bllokohet qarkullimi i mjeteve në kryqëzimin e urës së Lanës (VIDEO)
- 2

Plani i qeverisë/ Një agjenci për të gjitha pasuritë e paluajtshme, shkrihen Kadastra dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës
- 3

Protestuesit në bulevard përçahen, Balla i përshëndet nga Paskuqani pas dëgjësës me banorët
- 4

'Faji im që të jap muhabet' / Debat në 'Studio Live', Mehmeti: Mbroni pafytyrësisht skandalët! Valteri: Reciton fjalime, i del krah komunistit të fundit, Berishes (VIDEO)
- 5

I arrestuari dëmtoi kamerën, tavanin dhe orënditë në komisariatin e Sarandës, pezullohen 3 efektive

Kronikë

Plagosi dy persona në Laprakë, shpallet në kërkim autori (EMRI)

Policia e Tiranës ka identifikuar dhe shpallur në kërkim autorin e dyshuar të plagosjes së Bledar Dautit dhe Dashamir Tahirin e ndodhur mbrëmjen e së martës në zonën e Laprakës, në Tiranë.

■ Tiranë/ Të shtëna me armë zjarri në Laprakë, dy të plagosur! Gjendet automjeti i braktisur nga autorët (EMRAT+VIDEO)



Foto nga vendi i ngjarjes

Redaksia
9 Shtator, 11:37 | Përditësimi: 9 Shtator, 16:32

Share Post WhatsApp

A A

Policia e Tiranës ka identifikuar dhe shpallur në kërkim autorin e dyshuar të plagosjes së Bledar Dautit dhe Dashamir Tahirin, e ndodhur mbrëmjen e së martës në zonën e Laprakës, në Tiranë.

Hetuesit dyshojnë se konflikti mes tyre dhe Arbër Krrashit ka qenë i hershëm ndërsa nuk dihet nëse takimi i tyre ka qenë i rastësishëm apo kanë lënë vend takimi për t'u sqaruar. 36-vjeçari ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të Dautit e Tahirin, të cilët janë miq, për motive të dobëta, dhe është larguar me automjet. Mjeti u gjet i braktisur pas disa minutash.

Dy të plagosurit nuk kanë dhënë deklarime para hetuesve, dëshmia e të cilëve do të hidhte dritë mbi motivet e ngjarjes.

LEXO EDHE:

Protestuesit në bulevard përçahen, Balla i përshëndet nga Paskuqani pas dëgjësës me banorët

"Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore kryer nga specialistët e sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, me qëllim zbardhjen e autorësisë dhe rrethanave të plagosjes me armë zjarri, të shtetasve D. T. dhe B. D. (miq me njëri-tjetrin), rreth orës 21:20 të datës 08.09.2026, në Laprakë, u mundësua identifikimi i autorit të dyshuar të rastit, shtetasit A. K., 36 vjeç, banues në Tiranë.

36-vjeçari dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të 2 shtetasve, për motive të dobëta, dhe është larguar me automjet. Të dëmtuarit janë jashtë rrezikut për jetën.

Punohet intensivisht për lokalizimin dhe kapjen e shtetasit A. K", njofton Policia.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë për veprime të metejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Dashamir Tahir, Bledar Dauti, plagosje me arme zjarri, Tirane, arber krrashi

Sa e vlerësoni këtë artikull?



LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohe

SH

Sondazhi i ditës:

Ngërçi për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë?

7 Shtator, 07:56

Qeverisë Magjistratëve Nuk e di

Lajme të tjera



Tubimi në Tiranë/ Protesta ndahet në dy grupe, thellohet përçarja mes të pranishmëve! Bllokohet qarkullimi i mjeteve në kryqëzimin e urës së Lanës (VIDEO)

9 Shtator, 21:11



Jakin Marena: Koincidenca misterioze e 12 shtatorit, 'Flamingot' përplasen me 'UÇK'

Jakin Marena

9 Shtator, 19:00



Shpërthimi me 3 të plagosur te 'Eida' në Tiranë, eksperti Mehmeti: Pikat e karburanteve duhet të ndërtohen larg qendrave të banuara, shkollave e kopshteve!

9 Shtator, 18:29



Nga sot qytetarët mund të japin online vlerësimin e tyre për çdo përfaqësi konsullore, Hoxha: Përmirësojmë së bashku shërbimin, sjellim shtetin më pranë qytetarit!

9 Shtator, 15:52



Inteligjenca artificiale futet në prokurimet publike, Ibrahimaj jep afatin: Brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm! Teknologjia, rruga për të luftuar korrupsionin

9 Shtator, 13:46




Aksioni i pastrimit në Tiranë/ Pas Paskuqanit, Bashkia nis punë në lumin e Lanës në Shkozë

9 Shtator, 13:32



Drejtori i zjarrfikësës: Shpërthimi ndodhi te zyra e karburantit! Pati rrjedhje gazi (VIDEO)

9 Shtator, 09:53



Report Tv siguron pamjet e makinës që po furnizohej me gaz gjatë shpërthimit te karburanti 'Eida' (VIDEO)

9 Shtator, 09:25



Çfarë ka mbetur pas shpërthimit te karburanti 'Eida' në Tiranë

9 Shtator, 08:03



'Sharje dhe ofendime', protestuesit përplasen me njëri-tjetrin për bllokimin e rrugës në kryeqytet (VIDEO)

9 Shtator, 07:42



Shpërthim gazi te karburant 'Eida' në Tiranë, plagosen 3 punonjës! Dy versione për shkakun, Zjarrfikësja: Dyshohet se erdhi nga zyra! ISHTI: Flakët nisën nga një makinë! 3 të shoqëruar

Sokol Dema

9 Shtator, 07:24



Tiranë/ Të shtëna me armë zjarri në Laprakë, dy të plagosur! Gjendet automjeti i braktisur nga autorët (EMRAT+VIDEO)

8 Shtator, 22:04

Lajmi i fundit

Daton prej 98 vjetësh, OpenAI zgjidh një nga 'Problemat e Mijëvjeçarit' në matematikë brenda 88 orëve

9 Shtator, 21:44





RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



GetButton



Lajmi i fundit



Daton prej 98 vjetësh, OpenAI zgjidh një nga 'Problemat e Mijëvjeçarit' në matematikë brenda 88 orëve

9 Shtator, 21:44